

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70001-26-753-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material riparues teknik dhe Furnizim me paisje elektrike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Offishop Group SH.P.K.
NUI	811903104
Adresa	1
Vendi	Kosove
Kodi postar	1
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Offishop Group
Adresa elektronike	offishopgroup@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.04.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material riparues teknik dhe Furnizim me paisje elektrike

Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin “Furnizim me material riparues teknik dhe pajisje elektrike”, pasi OE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e FDT, nuk ka paraqitur të gjitha mostrat dhe produktet e ofruara nuk përputhen me specifikat teknike.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me date 24.04.2026 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke ngritur pretendime për mospërbushje të kërkesave të FDT nga OE i rekomanduar, përfshirë mospërputhje të specifikave teknike dhe mungesë të mostrave të detyrueshme gjatë verifikimit. Autoriteti Kontraktues me date 23.04.2026 ka refuzuar kërkesën tonë pa i shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe substanciale pretendimet e paraqitura. Bashkëngjitur kësaj ankese po dorëzojmë kopjen e vendimit të AK-së në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qëllimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 40 i rregullores së prokurimit publik-Ekzaminimi ,vlersimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale

Dosja e tenderit - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Neni 4.3 i rregullores 01/2022 për Prokurim Publik

Neni 17.17 i Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Lidhur me aktivitetin “Furnizim me material riparues teknik dhe furnizim me paisje elektrike”, kompania jone ka kërkuar qasje në dokumenta zyrtare më 14.04.2026 dhe po atë datë AK ka aprovu kërkesën dhe më datë 15.04.2026 09:00 deri ora 10:00 kemi qenë në qasje ku AK na ka ofruar qasjen në bazë të ligjit të LPP gjithashtu kemi kërkuar qasje edhe në prezantimin e mostrave të operatorit Fitues edhe aty na është dhënë qasje ku kemi qenë shumë Korrekt

Kompania jonë më datë 20.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit

Kontraktues, si rezultat i vendimit të datës 14.04.2026, me të cilin është shpërblyer me kontratë një Operator Ekonomik i cili, sipas vlerësimit tonë dhe bazuar në dokumentet e dorëzuar në ofertë, nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në (FDT).

Vendimi i AK-se nuk trajton në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar të gjitha pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim, por është fokusuar vetëm në disa çështje të kufizuara, duke anashkaluar shumicën e argumenteve dhe deshmive të paraqitura nga ana jone, ku vendimi i AK bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP, i cili garanton trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe transparencë, si dhe me nenin 59 të po këtij ligji, i cili obligon AK që të bëjë ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të drejtë dhe të plotë të ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.

Në kërkesën për rishqyrtim kemi paraqitur në mënyrë të detajuar mospërputhjet lidhur me mostrat, katalogun, referencat, mungesën e faturave, deklaratën për specifikimet teknike dhe Dokumentat e stafit të OE fitues, mirepo me datë me vendimin e datës 23.04.2026 keto çështje nuk janë trajtuar fare në vendimin e AK-se të ku në shumicën e pikave AK nuk ka kthyer përgjigje .

Pavaresisht këtyre fakteve, AK ka vendosur të shpallë fituese një kompani e cila nuk posedon një pjesë të madhe të dokumenteve të kërkuara në FDT, duke e konsideruar si të përgjegjshme një ofertë që nuk është e mbështetur me deshmë të plotë dhe të verifikueshme.

Në anën tjetër, kompania jone është eliminuar mbi një arsye që nuk ndikon në këtë aktivitet, konkretisht për shkak të drejtimit të diplomes së menaxherit të projektit dhe disa Cmime jo normalisht uletë ku dhe ja kemi argumentuar shumicën e tyre. Kompania jone ka paraqitur diplome të ekonomistit në drejtimin kontabilitet dhe financa, që është brenda fushës ekonomike dhe nuk e cenon aftësinë profesionale për menaxhimin e projektit.

Ky dallim nuk mund të konsiderohet si mospërputhje thelbësore që ndryshon rrjedhën e aktivitetit të prokurimit, dhe eliminimi mbi këtë bazë është joproporcional dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë .

Nga ana tjetër, për OE fitues nuk janë trajtuar fare mangësitë serioze si:

- 1.mospërputhja e mostrave me specifikimet,
- 2.mungesa e artikujve në katalog,
- 3.mungesa e deklaratës për specifikimet teknike,
- 4.mungesa e faturave dhe deshmive për realizimin e kontratave,
- 5.mospërputhjet në listën e kontratave dhe Referenca apo deshmë tjera

Kjo tregon qartë një trajtim jo të barabartë dhe një vlerësim selektiv të ofertave, në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Po ashtu, AK është fokusuar në disa cmime individuale të ofertes sone, duke anashkaluar faktin se oferta jone në total është më e favorshme ekonomikisht, duke mos respektuar parimin e Ruajtjes së Parase Publike të nenit 6 të LPP

Për keto arsye, konsiderojmë se vendimi i AK-se është i njëanshem, i paplotë dhe në kundërshtim me LPP .

Me poshht do I bashkangjesim te gjitha faktet dhe Argumentet e gjetura per operatorin fitues te keti aktiviteti ku ne baze te komisonit eshte marre OE I ploteson te gjitha kriteret per dhenje te Kontrates

Shkelja numer 1.

Sa i perket **Kërkesës 1**, ku është kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme gjatë 3 viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se dyfishin e vlerës së parashikuar, gjatë shqyrtimit të ofertës së OE të shpallur fitues kemi vërejtur se kjo kërkesë nuk është përmbushur në mënyrë të plotë dhe të dëshmuar.





OE fitues në ofertë ka paraqitur një listë kontratash me vlerë totale prej **204,000.00 €**, mirëpo si dëshmi për realizimin e tyre ka bashkëngjitur vetëm transaksione bankare dhe në vlerë totale prej **102,439.04 €**, dhe disa process verbale dhe kontrata pa dëshmi tjera a jan kryer punet ne baze te kontratave, që është dukshëm më pak se minimumi i kërkuar sipas FDT. Kjo shumë nuk e arrin vlerën e kërkuar prej dyfishit të vlerës së parashikuar dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet oferte e pergjegjshem Për më tepër, këto transaksione bankare nuk janë të shoqëruara me **faturat përkatëse**, prandaj nuk mund të vërtetohet se cilës kontratë i përket secila pagesë dhe cilat pozicione janë furnizuar apo realizuar. Duke pasur parasysh se OE fitues ka pasur edhe kontrata të tjera me përshkrime si **“Furnizim me material hidrosanitar, ujë, kanalizim dhe ngrohje”**, pa faturat përkatëse mbetet e paqartë nëse transaksionet e paraqitura lidhen realisht me kontratat e listuara dhe nëse ato janë të natyrës së njëjtë me lëndën e këtij projekti pasi te gjitha marrveshjet jan kryer shabllon ku ne pershkrim verehet qe OE ka kryher edhe furnizime

me Uje

Nr.	Grupi
1	Furnizim me material Hidrosanitar, Uje, Kanalizimit dhe Ngrrohje Qendrore.

Kjo eshte vetem nje deshmi per nje kontratat qe e kem bashkangjitur .

Po ashtu, gjatë kontrollimit të listës së kontratave kemi vërejtur se në një numër të madh të marrveshjeve është vendosur vetëm **viti**, pa datë të saktë të nënshkrimit (ditë dhe muaj). Kjo lë hapësirë për dyshim serioz, pasi nuk mund të vërtetohet nëse kontratat janë brenda periudhës 3-vjeçare të kërkuar. Mungesa e datave të plota e bën të pamundur verifikimin e saktë të vlefshmërisë së tyre dhe na lë të dyshojmë nëse këto dokumente janë përgatitur vetëm për nevojat të kësaj procedure

Firma:	LEADTECH SHPK	Emri:	Ngrohja SHPK
Emri i përfunduarit:	Përparim Osmani	Emri i përfunduarit:	Behar Rashiti
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	2023	Data:	2023
Vula:		Vula:	

Sipas LPP, AK ka obligim që të bëjë vlerësim të plotë të dëshmive dhe jo të mbështetet vetëm në një listë të kontratave pa prova të mjaftueshme për realizimin e tyre. Në këtë rast, mungesa e faturave, mospërputhja ndërmjet listës së kontratave dhe transaksioneve bankare, si dhe mungesa e datave të plota, tregojnë qartë se OE fitues nuk e ka dëshmuar përmbushjen e FTD gje qe na shti ne dyshime qe nuk jan reale ,ku dhe do ti argumentojem disa nga marrveshjet qe jan lidhur .

Listes se Kontratave -Furnizim me banera për nxemje qendrore në Spitalin e Përgjithshëm në oferta e OE fitues figuron vetëm kontrata, pa asnjë dëshmi shtesë që vërteton se furnizimi është realizuar dhe përfunduar me sukses. Për më tepër, është për t'u theksuar se kontrata përfundon me datë **24.02.2026**, ndërsa njoftimi për kontratë për këtë aktivitet është publikuar më **25.02.2026**, pra vetëm **një ditë para publikimit të njoftimit**. Kjo rrethanë lë hapësirë serioze për dyshim lidhur me kohën reale të realizimit të kësaj kontrate.

prokurime materiale përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 24.11.2025 dhe përfundon në datën 24.02.2026

Neni 2

Kontrata 28

Pozicioni 3 e Listes se Kontratave – “Furnizim me Konditioner ajri dhe kaldaja për ambulatën e fshatit Kufcë”, OE fitues ka bashkëngjitur vetëm kontratën, mirëpo nuk ka paraqitur asnjë dëshmi shtesë që vërteton se furnizimi është realizuar dhe përfunduar brenda afatit të përcaktuar ku nuk mund të vërtetohet nëse furnizimi është kryer apo jo dhe nëse është realizuar në kohën e caktuar sipas kontratës apo në Shumen e caktuar.

Te Pozicioni 4 e Listes se Kontratave “Furnizim me Klima për Njesine Koronare dhe Akusherit në repartin e gjinekologjisë”, kemi vërejtur një mospërputhje të qartë ndërmjet

kontrata ndersa komisioni vlersuar ne baze te analizave tona ka vlersuar si te vlefshme oferten e OE Fitues ,Duke pasur parsysh qe OE fitues nuk ka pasur deshmi referenca apo transaksione te mjaftushme per te arritur vleren e parapam ne FDT

Pozicioni 15 ne listen e kontratave – “Furnizim me material hidrosanitar, uji, kanalizim dhe ngrohje qendrore” me kompanine **DUA ARCH SHPK**, kemi verejtur mangesi serioze ne Marrveshjen e paraqitur nga OE fitues. Fillimisht, ne kontraten e bashkangjitur **nuk eshte cekur numri i biznesit / numeri unik identifikues i biznesit**, gje qe e ben te pamundur verifikimin e sakte te subjektit kontraktues ne **ARBK**.Kjo eshte ne kundershtrim me kerkesat themelore te vlefshmerise se dokumenteve kontraktuale ndermjet bizneseve, pasi sipas **Ligjit Nr. 06/L-016 per Shoqerite Tregtare dhe praktikave** ,dokumentet e lidhura ndermjet subjekteve afariste duhet te permbajne te dhenat identifikuese te paleve, perfshire emrin e plote dhe numrin e biznesit, ne menyre qe identiteti i paleve te mund te verifikohet ne menyre objektive.

Po ashtu, OE ne listen e kontratave e ka paraqitur kete pozicion me vlere **35,000.00 €**, ndersa si deshmi ka bashkangjitur vetem transaksione bankare ne vlere **32,171.15 €**,ne keto rrethana, OE eshte dashur qe ne listen e kontratave te paraqiste **vleren reale te deshmuar me transaksione**, pra **32,171.15 €**, dhe jo nje vlere me

Pozicionet 17–19 te listes se kontratave, OE fitues ka paraqitur dy marreveshje bashkepunimi te vitit 2023, mirepo te njejtat jane dorezuar **pa date te plote**, duke u shenuar vetem viti si ne marrveshje ashtu edhe ne liste te kontratave si te gjitha marrveshjet qe jan pa data te cekura .

Per shkak te mungeses se dites dhe muajit, nuk mund te vertetohet ne menyre te sakte se kur jane nenshkruar dhe ne cilen periudhe jane realizuar keto marreveshje, respektivisht nese hyjne realisht brenda periudhes se kerkuar nga FDT, ku eshte percaktuar qarte se OE duhet te deshmoje kontrata te natyres se ngjashme gjate 3 viteve te fundit nga data e publikimit te Njoftimit per Kontrate.Kjo pamundeson verifikimin marrveshjes kur eshte kryer dhe bie ndesh me **nenin 59 te Ligjit Nr. 04/L-042 te LPP**

Nga shqyrtimi i ofertes se dorezuar nga OE fitues, verehet se te gjitha marreveshjet e paraqitura nga sektori privat jane dorezuar **pa reference, pa raport realizimi, pa transaksion te plote dhe pa fatura perkatese**, gje qe le vend serioz per dyshim lidhur me realizimin e tyre real.

Sipas **nenit 59 te Ligjit Nr. 04/L-042 per LPP**, Autoriteti Kontraktues ka obligim qe te beje ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tenderve mbi baze te dokumenteve dhe deshmive qe vertetojne ne menyre reale permbushjen e kriterëve te kerkuara. Ky nen kerkon qe komisioni vleresues te mos mbeshtetet vetem ne nje liste kontratash apo marreveshje formale, por ne prova konkrete qe deshmojne realizimin e tyre.

Po ashtu, sipas FDT-se se kesaj procedure, eshte kerkuar qe OE te deshmoje se ka perfunduar me sukses kontrata te natyres se ngjashme, qe nenkupton jo vetem ekzistencen

e nje marreveshjeje, por edhe prova qe kontrata eshte realizuar faktikisht.

Ne interpretim te ketij neni, vetem marreveshja apo kontrata e nenshkruar nuk eshte e mjaftueshme pa: fature, transaksion bankar, reference nga klienti, fletepranim, ose raport realizimi.

Ne vecanti, eshte per t'u theksuar se nuk eshte bashkangjitur asnje fature nga sektori privat, edhe pse fatura perben deshmime kryesore qe verteton furnizimin dhe pagesen reale te mallrave apo sherbimeve.

Ne mungese te faturave, nuk mund te vertetohet: se cilat pozicione jane furnizuar ,ne cfare sasive jane realizuar, ne cfare date jane kryer dhe ne cilen vlere reale eshte ekzekutuar kontrata.

Kjo bie ndesh edhe me parimet e **nenit 7 te LPP-se**, i cili percakton trajtim te barabarte, proporcionalitet dhe transparence, pasi nje OE nuk mund te vleresohet me reference mbi baza dokumentesh qe nuk mund te verifikohen.

Per kete arsye, ekziston dyshim i arsyeshem se keto marreveshje mund te mos jene realizuar fare dhe jane paraqitur vetem si dokumente formale per qellime te kesaj procedure.

Kjo ka ndikuar drejtperdrejt ne vleresimin e komisionit vleresues, pasi OE fitues ka krijuar pershtypjen se posedon reference dhe kontrata te realizuara ne vlere me te larte se ajo qe mund te vertetohet me dokumente.

Si shembull konkret, te **Pozicioni 15**, vlere e paraqitur ne listen e kontratave nuk perputhet me deshmime financiare te bashkangjitura, gje qe tregon qarte se komisioni vleresues eshte vene ne lajthitje nga oferta e paraqitur nga OE. Ne keto rrethana, konsiderojme se komisioni eshte mbeshtetur ne dokumente te paargumentuara dhe jo te plota, ne kundërshtim me interpretimin e nenit 59 te LPP-se, duke e vleresuar oferten e OE fitues si te pergjegjshme, edhe pse nga oferta nuk mund te vertetohet realizimi real i kontratave te paraqitura.

DESHMIA 2

-Sa i perket deklarates per specifikimet teknike, OE fitues nuk e ka dorezuar deklarate te specifikacionit, ashtu sic kerkohet me LPP, por vetem ka bashkangjitur specifikimin teknik te marre nga dosja dhe te vulosur. Ky veprim nuk mund te konsiderohet si permbushje e kriterit, „Vetem vulosja e specifikimit teknik te FDT-se nuk do te thote se OE ka deklaruar ne menyre te qarte se mallrat e ofruara i permbahen specifikimeve te kerkuara. Per kete arsye, oferta e OE fitues nuk eshte ne perputhje me piken 3.1 te FDT-se dhe me nenin 59 te Ligjit te LPP.

DESHMIA 3

Sa i perket **Kerkeses 4**, ku FDT ka kerkuar qe OE te emeroje menaxherin e projektit me vendim dhe i njejt te jete *Ekonomist i diplomuar, drejtimi menaxhment, bachelor apo master, me se paku tri vite pervoje pune*, konsiderojme se komisioni vleresues e ka marre gabimisht si kusht te plotesuar.OE fitues ka paraqitur vetem listen e stafit me pervoje pune, mirepo kjo liste nuk permban nenshkrimet e stafit, dhe per me teper nuk eshte bashkangjitur CV-ja personale e menaxherit te projektit e nenshkruar nga vete personi.Sipas kerkeses se FDT-se, dokumentacioni duhet te jete i tille qe komisioni te mund te verifikojte ne menyre te plote:identitetin e personit te emeruar,kualifikimin profesional,pervojen e kerkuar,dhe pranimin e ketij roli nga vete personi.Vetem lista e stafit e dorezuar nga OE, pa nenshkrim dhe pa CV te nenshkruar nga menaxheri i projektit, nuk mund te konsiderohet si deshmi e mjaftueshme per permbushjen e ketij kriteri.

DESHMIA 4

Sa i perket katalogut dhe specifikimeve teknike te paraqitura nga OE fitues, kemi verejtur se ne oferte eshte paraqitur **Klime CHIGO me specifikim AERO 170**.

Kompania jone, duke qene e **autorizuar nga distributori per kete aktivitet**, per qellime te verifikimit a egzistone kjo marrveshje per shitjen e Klimes, ka kontaktuar drejtpersedrejti distributorin perms Emailin dhe ka kerkuar sqarim lidhur me:*nese ky specifikim eshte leshuar nga distributori,dhe nese ky model / lloj klime ekziston ne tregun e Kosoves*, dhe I vetmi I aturoizuar per shitjen e klimave ne kete projekte eshte Kompania jone .

Sipas pergjigjes se marre nga distributori permes emailit, i cili eshte bashkangjitur si deshmi, rezulton se ky specifikim nuk eshte leshuar nga ana e tyre dhe se ky lloj klime nuk rezulton te ekzistojte ne tregun e Kosoves. Te bashkangjitur ne foto e keni emailin e distributorit dhe Foton dhe specifikimin e katalogut te dorzuar na OE Fitues



Përshëndetje, ju lutem na konfirmoni nëse klima që është paraqitur në fotografi nga operatori tjetër ekonomik i parasysh se autorizimin për këtë brend na e keni lëshuar neve si kompa

SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

220/70001-26-753-1-2-1

Ky konfirmim na nevojitet për verifikim dhe sqarim të dokumentacionit.

Ne foto shihet pershkrimi ku eshte DC inverter AERO 170 ku dihet qe ky lloj klime eshte e brendit chigo

Ju lutem na informoni me Email.

FALEMINDERIT

Me respekt:
Offshop Group SHPK
Add."Gjilan"
Tel. [+383 49/633-452](tel:+38349633452)
Gjilan 60000
Republic of Kosovo

CK

CHIGO KOSOVA <chigokosov@gmail.com>

To: You

Pershendetje te nderuar ,

Klima ne foto dhe pershkrim eshte e brendit Chigo per te cilin jemi te autorizuar per Kosove ne dhe ky model nuk im disponueshem.

Autorizimin per kete aktivitet e ka kompania juaj dhe ne skemi autorizuar asnje kompani tjeter rreth ketij aktiviteti.

Per gjdo informat shtes mund te na kontaktoni.

Ju faleminderit



Kondicioner DC Inve
Klasa e energ
Sistem WiFi
Ristartim automatik
Vetëpastrohet
Filtra anti bakterial

Kjo krijon dyshim serioz lidhur me katalogut dhe specifikimeve teknike te paraqitura nga OE fitues. Per kete deshmi mund te referehoni edhe perms emailin

chigokosov@gmail.com

Si eshte e mundur qe AK te mbeshtetet vetem ne nje fotografi te paraqitur ne katalog, kur dihet se sipas FDT dhe praktikave te vleresimit, katalogu duhet te vertetoje ekzistencen reale dhe furnizimin e produktit, e jo vetem paraqitje vizuale nga vet operatoret ekonomik. Ne kete rast, OE ankues ka dorezuar deshmi shtese – konfirmim zyrtar nga distributori i autorizuar i brendit Chigo per Kosove – ku vertetohet se modeli i paraqitur nuk eshte ne treg, nuk importohet dhe nuk eshte i disponueshem.

Deshmia 5

Gjate shqyrtimit te mostrave kemi verejtur se OE fitues, per artikullin e kerkuar nga njesia kerkuese “**RF ID reader = kopjues universal per qipa dhe kartela te liftave dhe te rampave 6V - 12V - 24V - 220V**”, ka paraqitur vetem **nje lexues te kartelave**, siç shihet ne foton e



bashkangjitur

Sipas kerkeses se FDT-se dhe pershkrimit te njesise kerkuese, eshte kerkuar qarte nje **kopjues universal**, qe nenkupton pajisje me funksion **lexim dhe kopjim / shkrim**, pra pajisje qe ka funksion te dyfishte. Ndersa mostra e paraqitur nga OE fitues rezulton te jete vetem **reader / lexues**, i cili ka funksion vetem per leximin e kartelave dhe nuk e kryen funksionin e kopjimit. Per kete arsye, mostra e paraqitur nuk ka funksionin e njejte me ate qe eshte kerkuar dhe nuk i permbush nevojat e kerkuara nga njesia kerkuese. Te bashkangjitur e gjeni edhe mostren e ofruar nga kompania jone si duket pajisja e kerkuar Kopjues ku AK ne kerkesen per Rishqyrtim nuk ka kthyer pergjigje per kete pike .



DESHMIA 6

Verehet se komisioni vleresues nuk e ka shqyrtuar me kujdes katalogun e dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate, pasi ne katalog figurojne edhe disa pozicione te kerkuara nga FDT qe **nuk gjenden fare ne katalogun e paraqitur**. Si shembull konkret, pozicioni **“Drita (plafoni) Led 58W 60x60cm Armstrong”** nuk figuron ne katalogun e bashkangjitur nga OE fitues. OE i rekomanduar per kontrate ka ngarkuar vetem **nje katalog te vetem me Drita**, dhe nga shqyrtimi i tij nuk rezulton se ky artikull eshte i perfshire apo i pershkruar ne menyre te qarte. Kjo tregon se komisioni vleresues nuk e ka bere verifikimin e plote te dokumentacionit teknik dhe nuk ka krahasuar katalogun me te gjitha pozicionet e kerkuara nga njesia kerkuese.

Deshmia 7. Sa i perket mostrave, eshte evidente se OE fitues nuk ka paraqitur te gjitha mostrat e kerkuara sipas FDT. Nga fotografia e bashkangjitur, ku shihet qarte data dhe ora e verifikimit, vertetohet se gjate qasjes ne mostra nga kompania jone mungon produkti “Mbules per dysHEME nga poliesteri 180Gr/m²”. Ky produkt, duke qene material qe matet ne m², eshte lehtesisht i identifikueshem dhe prezenca e tij do te ishte e dukshme ne vendin e mostrave, mirepo nga provat rezulton se nuk eshte paraqitur fare. Si eshte e mundur qe AK ta konsideroje oferten si te pergjegjshme, kur nje nga mostrat e detyrueshme nuk eshte prezantuar gjate verifikimit fizik? Ne baze te Nenit 59 te LPP-se, komisioni vleresues ka obligim te verifikoje plotesimin e te gjitha kerkesave teknike, perfshire edhe mostrat, dhe mungesa e nje mostre perben mospërputhje te drejtperdrejte me specifikat e tenderit, qe duhet te rezultojte me eliminim te OE.

Per kete arsye, konsiderojme se oferta jone eshte ne perputhje me kerkesat e dosjes dhe se mospranimi i saj mbi baza te tilla perben veprim joproportional dhe ne kundërshtim me parimet themelore te prokurimit publik.

Lidhur me te gjitha pretendimet dhe deshmitë e paraqitura me lart, kerkojme nga Eksperti Shqyrtues dhe OSHP qe ta ktheje lenden ne rivleresimit te ofertave, si dhe nga AK ta shpalle kompanine tone si fituese te ketij aktiviteti te prokurimit, duke pasur parasysh se oferta jone eshte me cmimin me te favorshem dhe ne perputhje me kerkesat e dosjes, duke kontribuar ne ruajtjen e parase publike, ne perputhje me **nenin 6 te Ligjit per Prokurimin Publik – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te bera nga Autoriteti Kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit, kompanise sone i eshte shkaktuar dem material dhe ekonomik, pasi OE i rekomanduar per kontrate eshte vleresuar si i pergjegjshem edhe pse nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultojne mospërputhje serioze ne referenca, katalog, mostra dhe dokumente teknike. Kompania jone ka investuar mjete financiare dhe kohore per pergatitjen e plote te ofertes, duke perfshire sigurimin e mostrave, katalogeve, autorizimeve, stafit profesional dhe dokumentacionit te kerkuar sipas FDT-se. Po ashtu, per qellime te verifikimit te dokumentacionit te OE fitues, kemi bere shpenzime shtese materiale dhe administrative per: qasje ne dokumente zyrtare, verifikim te katalogeve dhe specifikimeve teknike, komunikim me distributorin e autorizuar, sigurimin e deshmive elektronike dhe fotografive, dhe pergatitjen e kesaj kerkese per rishqyrtim. Ne rast se vendimi i AK-se mbetet ne fuqi, kompanise sone i shkaktohet dem i drejtperdrejte ne formen e humbjes se mundesise per fitimin e kontrates dhe fitimit te ligjshem qe do te realizohej nga kjo procedure.

Kërkojmë që ankesa/kërkesa për ri-shqyrtim të aprovohet si e bazuar ne te kunderten jemi te detyruar te parashtrojme ankesë ne OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmitë) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*